



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Duke u bazuar në Rregulloren Nr. 2001/19 (Dega Ekzekutive e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisë në Kosovë), Rregulloren Nr. 2001/36 Mbi Shërbimin Civil të Kosovës, Urdhëresën Administrative Nr. 2003/2, Udhëzimin Administrativ Nr. MSHP/DASHC 2003/1 mbi procedurën e rekrutimit, Ministria e Drejtësisë shpallë këtë:

K O N K U R S

I: SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS

1. Pozita: Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Lipjan - 1 (një vend pune) - rishpallje

Referenca: MD/SHKK/18 - 08 - 01 - 2010

Paga: 358 € Koeficienti: 10

I përgjigjet: Zëvendës Komisionarit të SHKK-së

Vendi: Qendra e Paraburgimit Lipjan

Qëllimi i punës dhe rezultatet

- Drejton dhe siguron menaxhimin gjithëpërfshirës të Qendrës së Paraburgimit.
- Siguron të gjitha komponentët e planifikimit dhe implementimit për të zhvilluar Qendrën e Paraburgimit.
- Siguron një sistem të efektshëm kontrollues për të gjitha çështjet ekonomike, politike dhe strukturale të Qendrës së Paraburgimit.

Përgjegjës për:

- Përgjegjës për menaxhimin e financave dhe buxhetit të Qendrës së Paraburgimit,
- Përgjegjës për krijimin e një ambienti të sigurtë në institucionin e vet,

Përgjegjësitë e mbikëqyrjes:

- Siguron implementimin e strukturës së udhëheqjes dhe organizimit
- Është përgjegjës për informimin në të gjitha nivelet (raporte, mbledhje)
- Siguron të gjitha dokumentet e nevojshme për Drejtorinë Qendrore
- Përfaqëson kontaktet e burgut me agjensionet e jashtme
- Përgjegjës për menaxhimin e financave dhe buxhetit të Qendrës së Paraburgimit
- Përgjegjës për procesin e planifikimit të dënimit
- Përgjegjës për qeshjet disiplinore për stafin dhe të burgosurit

Detyrat Kyçe:

- Siguron drafte, raporte, kërkesa në nivelin e pozitës së Drejtorit.
- Mbanë takime të rregullta me Drejtorinë Qendrore dhe stafin e tij vartës
- Verifikon të gjitha standardet e burgut, përfshirë edhe sigurimin
- Menaxhon dhe koordinon të gjitha çështjet specifike të stafit dhe të burgosurve (regjimet, ankesat, pushimet etj.)
- Përcjell realizimin e projekteve kryesore të Qendrës së Paraburgimit,
- Viziton rregullisht të gjitha zonat, hapësirat e Qendrës së Paraburgimit.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

- Përgatitje universitare në Pedagogji, Psikologji, Fakulteti Juridik, Fakulteti Ekonomik ose të ngjashme.

- Trajnimet profesionale te nevojshme në lëmin korrektues.
- Së paku 3 (tri) vite përvojë pune në SHKK apo jashtë Kosovës ose në fushën e sistemit të Drejtësisë,
- Certifikata mjekësore.
- Certifikata që nuk është nën hetime apo i dënuar mbi 6 muaj.
- Të mos jetë iniciuar procedura Penale dhe të mos jetë shpallur fajtor për ndonjë vepër penale,
- Të ketë aftësi në udhëheqje, organizim, komunikim dhe raportim,
- Drejtori duhet të ketë aftësi të shkëlqyeshme komunikimi të ideve të ndërlikuara gojarisht dhe aftësi të përgatitjes së raporteve të qarta, të kuptueshme dhe të qëndrueshme.
- Aftësi të zhvilloj dhe udhëheq ekipe të ndryshme në kuadër të Shërbimit,
- Aftësi të punoj në mjedisin shumë etnik, shumë kulturor duke mbajtur marrëdhënie efektive të punës me të gjithë anëtarët e ekipit;
- Aftësi për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie me bashkëpunëtorë të jashtëm.

Periudha e kontratës:

Punësimi bëhet me kontratë, kontrata e punës lidhet për periudhë kohore prej 1 viti, me 3 muaj punë provuese dhe me mundësi të vazhdimit të kontratës.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Ministria e Drejtësisë / Divizioni i Burimeve Njerëzore, Rruga « Ish-Ndërtesa e Rilindjes» kati i 7 - të, Zyra Nr. 723, Prishtinë, Kosovë;

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni zyrën e Divizionit të Burimeve Njerëzore në, tel: 038 / 213 860 ose 038 - 200 182 86), prej orës 08:00 - 16:00.

Konkursi ngel i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërin nga gazetaret ditore, duke filluar nga data **18.08.2010** gjer më datën **01.09.2010** që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijn brenda 4 ditësh, aplikacionet që arrijn pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

Kandidatët të cilën hynë në përzgjedhje të ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga personeli.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë përmes telefonit dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para komisionit intervistues.